



Implemented by



Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

Njoftim per THIRRJE PËR APLIKIME Nr. 04/2017 Skema e Grantit SARED

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave - MBZHRAU në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) shpallin të hapur **Thirrjen e Katërt për Aplikime për Skemën e Granteve të SARED për investime në sektorin agro-ushqimor për 3 zinxhirë të vlerës: ZV 1 - ripërtypësit e vegjël, ZV 2- frutat dhe arrorët dhe ZV 3- bimët aromatike dhe mjekësore (BAM).**

Thirrja e 4 është e hapur nga 01 Mars 2017 - 31 Maj 2017 në orën 16:30

Fondi i Grantit të projektit SARED bashkëfinancohet nga qeveria Gjermane dhe ajo e Danimarkës, ndërsa GIZ është Autoriteti Kontraktues. Zbatimi i projektit bëhet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave - MBZHRAU.

Buxheti i përgjithshëm i grantit për të gjitha thirrjet është rreth **910.000.000 lekë (ekuivalent i 6.500.000 euro) i cili përbën kontributin publik.**

Thirrja është e hapur për të gjithë qytetarët (fermerë individualë, persona fizikë dhe juridikë përfshirë edhe SHBB-të) sipas përcaktimit në UpA të cilët ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe/ose bashkëveprojnë me prodhues në territorin e 6 rajoneve të përzgjedhura të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Berat dhe Korçë, në prodhimin, grumbullimin, agro-përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore brenda 3 zinxhirëve të vlerës, (i) të ripërtypësve të vegjël, (ii) të frutave dhe arrorëve, dhe (iii) të bimëve mjekësore dhe aromatike (BAM).

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen vetëm personalisht në zyrat e Drejtorive Rajonale të Bujqësisë (DRB) në rajonet tuaja përkatëse gjatë orëve normale të punës në një zarf duke shënuar emrin e aplikantit dhe ZV për të cilët paraqitet aplikimi dhe të përmbajë formularin e aplikimit, planin e biznesit, si dhe dokumentet shoqëruese, siç tregohen në Udhëzimin për Aplikantët.

Kriteret për prioritetet në hapjen dhe vlerësimin e aplikimeve janë shpjeguar në Udhëzuesin për Aplikantët (UpA) dhe shtojcat përkatëse të cilat gjenden on-line në faqen e internetit të MBZHRAU www.bujqesia.gov.al (Logo SARED).

Madhësia totale e investimit të pranueshëm për një aplikim (projekti i investimit) është:

Për investimet në Fermë:

- Madhësia minimale e investimeve për të cilën duhet të aplikohet: **400.000 Lekë**
- Madhësia maksimale e investimeve për të cilën duhet të aplikohet: **3.500.000 Lekë**

Për investime jashtë Ferme (Mbledhja / përpunimi / marketingu i produkteve bujqësore):

- Madhësia minimale e investimeve për të cilën duhet të aplikohet: **700.000 Lekë**
- Madhësia maksimale e investimeve për të cilën duhet të aplikohet: **10.000.000 Lekë**

Për përfituesit madhësia financiare e grantit bazë do të jetë midis 50% - 65% e shpenzimeve totale të pranueshme. Granti paguhet në llogarinë bankare të përfituesit vetëm pas përfundimit të investimit për të cilin aplikuesi është pajisur me kontratë.

Për investimet në Fermë madhësia e grantit është midis 65% - 75% e kostove të pranueshme siç përshkruhen në UpA.

Për investimet jashtë Ferme (grumbullues dhe ose përpunues) madhësia e grantit është midis 50% - 60% e kostove të pranueshme siç përshkruhen në UpA.

Për Thirrjen e 4 për aplikime, janë të pranueshme vetëm **modelet e dokumentave te aplikimit** (formulari i aplikimit dhe formati i biznes planit) **dhe të aplikueshme vetëm kushtet që përmban Udhëzimi për Aplikantët Versioni 4, të publikuar në faqen e internetit të MBZHRAU www.bujqesia.gov.al** nga ku mund të shkarkohen.

Aplikimet mund të paraqiten vetëm për investime siç përshkruhet në Listën e Investimeve të Pranuara (Aneksi 3 në Udhëzimin për Aplikantët - UpA), publikuar në faqen e internetit të MBZHRAU.

Aplikantët potencialë duhet të bëjnë kujdes pasi:

Aplikimet e dërguara me ndonjë mënyrë tjetër ose në adresa të tjera do të refuzohen.

Çdo aplikim i dorëzuar ose i marrë pas skadimit të afatit përfundimtar të thirrjes do të refuzohet automatikisht.

Mospërputhja me kërkesat e tjera të mëdha formale siç renditen në Udhëzimin për Aplikantët përbën një arsye tjetër për refuzim automatik të aplikimit.

Informacioni mbi datat dhe vendet e takimeve që do të organizohen në lidhje me këtë thirrje gjenden në faqen e internetit të MBZHRAU.

Detajet e kontaktit për pyetje të mëtejshme:

MBZHRAU:

Tel: +355 4 22 23 825

Email: julinda.bare@bujqesia.gov.al

SARED / GIZ:

Tel: +355 (0) 4 248 6633

Email: sared@giz.de